



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2069, datë 21.06.2012

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 21.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);

- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.”
- Shkresa e Altelecom sh.a., me nr. 2691Prot., datë 30.5.2012 (nr. 902/5Prot. i AKEP, datë 5.6.2012) drejtuar Nisatel sh.p.k. dhe për dijeni AKEP: “*Sqarim lidhur me pretendimet e ngritura nga Nisatel sh.p.k.*”;
- Shkresë e Nisatel sh.p.k. me nr. 404/2Prot., datë 12.6.2012, “*Kërkesë për marrjen e një vendimi administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Altelecom sh.a.*”;
- Shkresë e Nisatel sh.p.k., me nr. 404/3 Prot., datë 14.6.2012, “*Mbi situatën e re të krijuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Altelecom sh.a.*”;
- Korrespondenca e shkëmbyer me postë elektronike (email) si edhe,
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

AKEP me anë të Vendimit nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- *“Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.”;*
- *Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;*
- *Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit”;*

I. Altelecom sh.a., me shkresën nr. 2691Prot., datë 30.5.2012 (nr. 902/5Prot. i AKEP, datë 5.6.2012) drejtuar Nisatel sh.p.k. dhe për dijeni AKEP *“Sqarim lidhur me pretendimet e ngritura nga Nisatel sh.p.k.”*, sqaron se:

Në datë 22.05.2012 u zhvillua takimi i kërkuar nga Nisatel me përfaqësues Z.Sadrit Danaj dhe me përfaqësuesit e Altelecom lidhur me sqarimin e pretendimeve të ngritura nga Nisatel, si më poshtë:

1. Mbi pezullimin e trafikut ndërkombëtar për thirrjet e tranzituara nga rrjeti Nisatel për terminim në rrjetin Altelecom nga data 11 Maj 2012
2. Negocimin e Tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara nga Altelecom për terminimin në rrjetin Nisatel
3. Amendimin e Marrëveshjes ekzistuese të Interkoneksionit për tranzitimin e thirrjeve kombëtare nga rrjeti Nisatel për terminim në rrjetin Altelecom

Lidhur me pikën e parë Altelecom sqaron se, Nisatel nuk përmbush detyrimet e vendosura në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi për autorizimin nga AKEP për ofrimin e shërbimit të tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

Nisatel pranoi në pranim proceduarat e ndjekura nga Altelecom lidhur me zbatimin e vendimit të fundit rregullator mbi regjimin e autorizimit të përgjithshëm. Gjithashtu Nisatel ka dërguar edhe dokumentacionet përkatëse lidhur me nënshkrimin e Amendamentit të njoftuar nga Altelecom ku reflektohet ndryshimet e RIO-s së Altelecom dhe Nisatel u angazhua për dërgimin e Amendamentit të nënshkruar së bashku me dokumentat plotësuese të munguara.

Lidhur me pikën e dytë, sqaron se po vlerësohet përcaktimi i tarifës së terminimit të trafikut ndërkombëtar të tranzituar nga Altelecom për terminimin në rrjetin e Operatorëve Alternativ dhe duke patur parasysh detyrimin ligjor për mosdiskriminim, altelecom ka për detyrë tju paraqis të njëjtën tarif të gjithë Operatorëve Alternativë që kanë Marrëveshje Interkoneksioni me Altelecom, tarifë të cilën do t’jua bëjë të njohur me anë të njoftimeve zyrtare. Me dakortësin e palëve, këto ndryshime do të bëhen pjesë e Amendamenteve përkatëse të Marrëveshjes së Interkoneksionit.

Lidhur me pikën e tretë që trajtuar në këtë takim, si dhe në vijim të sqarimeve të bëra në shkresën tonë datë 20.04.2012, për realizimin e tranzitimin e trafikut të Operatorëve të tjerë Alternativ nga rrjeti Nisatel për terminim në rrjetin Altelecom, është një shërbim i cili nuk është parashikuar në RIO-n e Altelecom për ofrimin e këtij shërbimi ka investuar dhe ka ofruar kushte të njëjta dhe mundësi reale për të gjithë operatorët alternativë që kanë marrëveshje direkte me Altelecom.

- II. Nisatel sh.p.k., me shkresën nr. 404/2Prot., datë 12.6.2012, “Kërkesë për marrjen e një vendimi administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Albtelecom sh.a.” ka sqaruar si më poshtë:

Nisatel parashton komentet e veta në lidhje me efektet e derregullimit të tarifës së trafikut ndërkombëtar në rrjetet fikse dhe nevojës për rregullimin e disa aspekteve të kesaj tarife.

Nisatel mendon se, vendimet më të fundit të AKEP mbi heqjen e rregullimit të tarifës ndërkombëtare për terminimin e thirrjeve drejt OFNT, duke e bërë atë një tarifë komerciale, praktikisht kanë ndikuar në mënyrë jo të barazvlefshme për operatorët e tjerë kombëtare. Ata e kanë të pamundur të përcaktojnë vetë apo të negociojnë tarifën e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e tyre të terminuar nga Albtelecom.

Sot Operatorët Alternativë (OA) janë të paqartë se si do të veprohet në rastet kur Operatori Albtelecom, që është operatori *absolut* i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet tona fikse nuk është dakord me tarifën e vendosur (kërkuar) nga operatorët e tjerë kombëtarë që veprojnë në zona lokale dhe ku shumica janë në zonat rurale.

Albtelecom në përcaktimin e tarifës për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e tij ka përcaktuar një tarifë (6.1 lekë/min) e cila pritet shumë shpejt të rritet edhe më shumë sipas parashikimeve aktuale, të barabartë për të gjithë operatorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë duke mos parashikuar asnjë marzh fitimi për operatorët kombëtarë që terminojnë këtë lloj trafiku në rrjetin e tij, ndërkohë që në negociatat me, operatorët e tjerë kombëtarë, propozon dhe kërkon që tarifa e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare tranzituar nga Albtelecom drejt rrjeteve të këtyre operatorëve të jetë 3.54 lekë duke përfituar një marzh 2.56 lek/min, të barabartë me 42% të tarifës ndërkombëtare aktuale (6.1 lek/min).

OA, duhet të dalin në tregun ndërkombëtar të terminimit drejt OFNT me një tarifë mbi atë të kërkuar prej tyre (në këtë rast Albtelecom, prej 6.1 lek/min) për të siguruar një marzh sado të vogël fitimi dhe Albtelecom për terminimin tonë të këtyre thirrjeve nuk e bën këtë gjë, ndërkohë që e ka mundësinë për ta realizuar atë, pasi është operator i vetëm real që dominon praktikisht këtë treg, bile mund të realizojë një marzh të kënaqshëm të diktuar (vendosur) nga ai vetë.

Nisatel shtron pyetjet:

Po në rastet kur Albtelecom ndryshon (rrit) tarifën e terminimit ndërkombëtar (me të drejtën që i japin ndryshimet e fundit rregullatore mbi bazë të cilave ai mund të ndryshojë këtë tarifë vetëm me një lajmërim 7 ditor, si do të veprohet me tarifën tonë të terminimit ndërkombëtar?

A kanë OA të drejtë ta ndryshojmë atë apo duhet të fillojmë negociatat të pambarimta dhe zvarritëse deri në lodhje me Albtelecom, ku në rastin më të keq për të, të përfitojë 5-6 muaj ndryshimin e kesaj tarife për shkak të këtyre zvarritjeve?

Përse Albtelecom nuk është dakord që marzhi (tarifa) e terminimit për këto thirrje të vendoset në negociatat me ne operatorët e tjerë kombëtarë dhe të jetë i njëjtë si për thirrjet ndërkombëtare që tranzitohen nga Albtelecom drejt nesh, ashtu edhe për ato që terminohen nga ne drejt tyre?

Mendojmë se, ndryshimet e fundit rregullatore lidhur me këtë treg u morën për bazë do të sjellin rritje të ardhurash për OFNT dhe do të përkthehen në më tepër investime dhe teknologji të re, dhe kjo është një arsye e mjaftueshme edhe për ne, për të rritur shërbimet dhe futur teknologjinë e re në zonat ku veprojmë.

Me zhvillimet e fundit të tregut të telefonisë fikse ku Albtelecom dhe AMC nëpërmjet teknologjive të reja arrijnë të japin shërbime edhe në zonat rurale dhe është rritur me shumë konkurrenca dhe për arsyen se Operatorët e mëdhenj përfitojnë nga liberalizimi i terminimit ndërkombëtar dhe OA nuk mund ta shfrytëzojnë si duhet atë për të gjitha sa më sipër, dhe për këtë arsye ndihemi më të kërcënuar nga konkurrenca e tyre dhe nëse ky treg nuk rregullohet shkojmë drejt falimentimit.

Rregullimet e fundit mbi terminimin ndërkombëtar kanë përjashtuar Operatorët e vegjël nga ky treg duke i lënë monopolin OFNT-ve si dhe përfitimi i OFNT-ve nga këto ndryshime ka rritur në disa herë fitimet për to, ndërkohë që operatorët e vegjël vetëm kanë humbur ose në rastin më të mirë u është propozuar një rritje e papërfillshme. Mendojmë se të gjitha veprimet apo vetot që vendos Albtelecom për këto lloj shërbimi bazohen në pozitën e tij dominuese në këtë treg.

Për sa më sipër kërkojmë edhe njëherë nga Këshilli Drejtues i AKEP:

Marrjen e një vendimi të shpejtë administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis Nisatel dhe Albtelecom për:

- a- Përcaktimin e tarifës së terminimit të trafikut ndërkombëtar në rrjetin Nisatel nga Albtelecom.
- b- Datën e hyrjes në fuqi të kësaj tarife .
- c- Nënshkrimin e një amendamenti me këto terma.

Gjithashtu, Nisatel sh.p.k, me shkresë me nr. 404/3 Prot., datë 14.6.2012, “*Mbi situatën e re të krijuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Albtelecom sh.a.*” sqaron se ka mbërritur një “*info*” nga Albtelecom (e-mail bashkëlidhur) nëpërmjet të cilit Departamenti i Interkoneksionit i ketij operatori njofton se: Albtelecom, ka propozuar tarifën e re të terminimit në rrjetin Nisatel të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga Albtelecom në vlerën 5.4 lekë/min dhe 0.83 lekë për thirrje duke filluar që nga data 1 Korrik 2012. Për sa më sipër, brenda datës 22.06.2012, ju mirëpresim në ambientet e Albtelecom për nënshkrimin e Amendamentit përkatës të Marrëveshjes së Interkoneksionit i cili do të marrë fuqi ligjore me datë 1 Korrik 2012.

Në datë 14.06.2012 Nisatel i është përgjigjur Albtelecom (e-mail bashkëlidhur) ku midis të tjerash sqaron:

Referuar ndryshimeve rregullatore të miratuara nga AKEP lidhur me regjimin e ri rregullator për shërbimin e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt destinacioneve kombëtare, i cili lejon palët, të negociojnë tarifa të favorshme, në baza

komerciale, Nisatel i propozon Albtelecomit tarifën e re të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin Nisatel në vlerën 7,0 lekë/min +0.83 lek/thirrje.

Ky cmim bazohet në rritjen që pëson në tregun ndërkombëtar trafikun i thirrjeve të terminuara në Shqipëri në rrjetet fikse, i cili nga data 1 Korrik 2012 bëhet 8.5 lek/min.

Marzhi prej 1.5 lek/min është më se i argumentuar duke qenë se dhe pika e lidhjes për trafikun ndërkombëtar (Nisatel-Albtelecom) është ajo e përcaktuar nga Albtelecom, DTA Tiranë për të cilën Nisatel ka shpenzuar dhe realizuar me investimin e vet segmentin Vlore-Tiranë.

Këtë argument e përmban edhe propozimi dhe oferta e bërë nga Nisatel në negociatën e fundit dypalëshe mbi mosmarrëveshjen e kësaj tarife, të cilën e kemi përmbledhur me anë të shkresës dt. 23.05.2012, Nr. Prot 304/12 drejtuar Albtelecom dhe Drejtorisë Juridike të AKEP.

Duke parë se volumi i trafikut ndërkombëtar të terminuar në rrjetin Nisatel nga Albtelecom (*sipas tabelave të matjeve*) kap vlerën mesatare të 350 mijë min/muaj, vlera prej 1.5 lek/min përmban më së miri edhe interesin e Albtelecom.

Edhe po të shikojmë cmimet me të cilat punojnë sot carrier-et ndërkombëtar në Europë vlera e propozuar nga Nisatel është optimale dhe e tejkalon atë të *carrireve* internacional si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje.

Njëkohësisht theksojmë faktin se tarifa e propozuar nga ana e Albtelecomit nuk është një tarifë e argumentuar dhe bazuar në realitetin e këtij tregu, ajo bazohet thjesht në faktin e pozitës dominante që Albtelecom ka në këtë treg dhe për shkak të saj mund të imponojë cmime me përfitime maksimale (qysh prej dt 15.02.2012 Albtelecom tranziton 100% të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet fikse).

Duke parë se tarifa e këtyre thirrjeve në tregun ndërkombëtar brenda 3-4 muajve ka ndryshuar dy herë mendojmë se thelbi i negociatave dypalëshe është përcaktimi i një tarife fikse tranziti për Albtelecom për këto thirrje e cila do të zgjidhte përfundimisht trajtimin e herëpashërshme në cdo rast të ndryshimit të tarifës ndërkombëtare.

Për të gjitha sa më sipër, dhe në vazhdimësi të problematikës së hetimit administrative të hapur nga AKEP me VKD Nr.1974, datë 01.06.2012, zgjidhja e mosmarrëveshjes Nisatel – Albtelecom është bërë emergjente.

Ngërçi i krijuar në këtë marrëdhënie e cila zgjat që nga data 15.2.2012 ka vënë në veshitësi sipërmarrësin Nisatel edhe në lidhje me organet tatimore si dhe zgjatja e këtyre negociatave përbën një presion me tepër për Nisatel duke favorizuar gjithnjë e më tepër nga ana tjetër OFNT-Albtelecom.

- I. AKEP, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet sa më sipër, gjykon se:
- a. AKEP nëpërmjet vendimeve të marra më 20.12.2011, ka përcaktuar se tarifa e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet e operatorëve me FNT nuk është më objekt rregullimi ex-ante. Për sa i përket rregullimit të tarifave të terminimit në rrjetet e operatorëve alternativë të telefonisë fikse, këto tarifa nuk kanë qënë dhe nuk janë objekt rregullimi ex-ante. AKEP ka marrë vendime në lidhje me mosmarrëveshje që kanë lindur midis operatorëve vendas për tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare, pra të origjinuara nga pajtimtarët vendas, pasi këto kanë efekt në konkurrencën në tregjet me pakicë në Shqipëri. Një rast i tillë ishte mosmarrëveshja midis Nisatel dhe AMC, të cilën AKEP e zgjidhi me VKD nr.1870 datë 10.04.2012.
 - b. Për sa i përket tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Nisatel, thirrje të tranzituara nga Albtelecom, vëmë në dukje se:
 - i. Tregu i tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare (hyrëse dhe dalëse) bazuar në analizën e tregut të telefonisë fikse 2010 dhe VKD nr.1348, datë 26.07.2010, nuk përbën treg të justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, dhe nuk ka anjë operator me FNT në këtë treg, pra edhe Albtelecom nuk është më operator me FNT dhe nuk ka detyrime për kontroll të tarifës së tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare (hyrëse dhe/ose dalëse);
 - ii. Bazuar në pretendimet e Nisatel dhe të Albtelecom, vihet re se Albtelecom i ka ofruar Nisatel tarifa më të larta për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin Nisatel se ato para de-rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin Albtelecom, si dhe një rritje e konsiderueshme e kësaj tarife është propozuar nga Albtelecom duke filluar nga 1.07.2012. Njëkohësisht vihet re se Albtelecom ka propozuar tarifa të tilla edhe për operatorë të tjerë.
 - iii. Nëse Nisatel nuk është dakort me tarifën/tarifat e propozuara nga Albtelecom, Nisatel ka mundësinë që të mos pranojë këtë shërbim nga Albtelecom dha të marrë thirrje hyrëse ndërkombëtare nga operatorë të tjerë tranzitues ose nëpërmjet vet-tranzitimit. Albtelecom nuk është operatori i vetëm tranzitues i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në Shqipëri, madje ka një numër të konsiderueshëm operatorësh që kanë kryer këtë shërbim (përfshirë Nisatel) për terminim drejt operatorëve celularë dhe Albtelecom;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”.
2. Të mos pranojë kërkesat e Nisatel sh.p.k për përcaktim tarife të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Nisatel në MI me Albtelecom.
3. Të njoftohen palët e interesuara Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE